

Thirrja nga data 29.07.2026 deri në datën 21.08.2026

TERMAT E REFERENCES

EKSPERT/E

Të dhënat mbi OJQ “Nevo Koncepti” dhe kërkesat për shërbimin e punëtorisë.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI
Objektiva	Zbatimi i metodologjisë së Kartelës Komunitare të Vlerësimit në institucionet shëndetësore për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijë dhe mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga muaji Tetor të vitit 2025 ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit. Ky projekt synon të fuqizojë pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje përmes krijimit dhe funksionalizimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Asambleja Komunale e Fëmijëve përbëhet nga 45 anëtarë të zgjedhur nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në përbërje të saj janë të përfaqësuara komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian. Gjithashtu, në Asambleshë Komunale të Fëmijëve marrin pjesë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët kontribuojnë dhe angazhohen në aktivitetet e ndryshme që organizohen nga anëtarët e saj.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është një projekt i implementuar nga OJQ Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children në Kosovë dhe financuar nga Sida. Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe rritja e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, gjatë hartimit të politikave dhe organizimit të aktiviteteve komunale.

Në kuadër të projektit, është mbështetur krijimi dhe funksionalizimi i Asamblesë së Fëmijëve në nivel komunal, e përbërë nga nxënës të 13 shkollave fillore të mesme të ulëta në komunën e Prizrenit.

Përveç Prizrenit, projekti zbatohet edhe në komunat e Suharekës, Dragashit dhe Rahovecit, duke kontribuar në fuqizimin e zërit të fëmijëve dhe përfshirjen e tyre aktive në vendimmarrje në nivel lokal.

3. OBJEKTIVA

Objektiva e këtij aktiviteti është zbatimi i metodologjisë së Kartelës Komunitare të Vlerësimit në institucionet shëndetësore, me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e qasshmërisë, cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore për fëmijë, si dhe funksionimit të mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe politikat kombëtare në fushën e shëndetit publik dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Përmes këtij procesi synohet të forcohet llogaridhënia sociale dhe bashkëpunimi ndërmjet komunitetit, institucioneve shëndetësore dhe akterëve relevantë, duke siguruar pjesëmarrjen aktive të fëmijëve, prindërve, kujdestarëve dhe ofruesve të shërbimeve shëndetësore në identifikimin e sfidave dhe adresimin e nevojave prioritare.

Temat dhe aktivitetet kryesore që do të trajtohen gjatë këtij procesi janë:

- * Zbatimi i metodologjisë së Kartelës Komunitare të Vlerësimit në institucionet shëndetësore, duke përfshirë planifikimin, koordinimin dhe facilitimin e procesit.
- * Vlerësimi i qasshmërisë, cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore për fëmijë, bazuar në perceptimet dhe përvojat e përdoruesve të shërbimeve dhe ofruesve të tyre.
- * Vlerësimi i funksionimit dhe efektivitetit të mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve brenda sektorit shëndetësor.
- * Lehtësimi i dialogut ndërmjet komunitetit dhe institucioneve shëndetësore për identifikimin e prioriteteve dhe hartimin e planeve të përbashkëta të veprimit.
- * Përgatitja e raportit përfundimtar, i cili përmbledh gjetjet kryesore, rekomandimet dhe planin e veprimit për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve.

Përmes këtij procesi synohet të kontribuohet në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për fëmijë, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, si dhe forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal.

4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti/ja i/e angazhuar për zbatimin e metodologjisë së Kartelës Komunitare të Vlerësimit në institucionet shëndetësore do të ketë për detyrë të udhëheqë dhe koordinojë të gjithë procesin e vlerësimit, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe profesionale gjatë gjithë angazhimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë përfshijnë:

- Hartimin dhe zhvillimin e metodologjisë së punës për zbatimin e Kartelës Komunitare të Vlerësimit, duke përfshirë përgatitjen e planit të punës, instrumenteve të mbledhjes së të dhënave dhe materialeve mbështetëse.

- Koordinimin dhe facilitimin e takimeve, punëtorive dhe sesioneve konsultative me institucionet shëndetësore, fëmijët, prindërit, kujdestarët dhe akterët e tjerë relevantë.
- Sigurimin e pjesëmarrjes aktive dhe gjithëpërfshirëse të të gjitha palëve të interesit gjatë procesit të vlerësimit.
- Mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave lidhur me qasshmërinë, cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore për fëmijë, si dhe funksionimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve në sektorin shëndetësor.
- Identifikimin e sfidave, nevojave dhe praktikave të mira në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve.
- Lehtësimin e dialogut ndërmjet komunitetit dhe institucioneve shëndetësore për identifikimin e prioritetëve dhe hartimin e planeve të përbashkëta të veprimit.
- Sigurimin që i gjithë procesi të zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, politikat kombëtare, standardet etike dhe procedurat e organizatës.
- Ofrimin e komunikimit të qartë dhe profesional, si dhe raportimin e rregullt mbi ecurinë e aktivitetit tek menaxheri i projektit.
- Përgatitjen dhe dorëzimin e raportit përfundimtar, i cili përfshin metodologjinë e përdorur, gjetjet kryesore, rekomandimet dhe planin e veprimit për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijë dhe mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve.
- Deklarata për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Safeguarding
- OJQ Nevo Koncepti është e përkushtuar të sigurojë një mjedis të sigurt dhe mbrojtës për të gjithë fëmijët dhe të rriturit në rrezik. Organizata zbaton Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve (Child Safeguarding Policy), Politikën për Mbrojtjen nga Shfrytëzimi, Abuzimi dhe Ngacmimi Seksual, si dhe politikat e tjera përkatëse të safeguarding.
- Eksperti/ja i/e angazhuar përmes kësaj thirrjeje, para nënshkrimit të kontratës, do të jetë i/e obliguar të:
 - respektojë dhe zbatojë të gjitha politikat e safeguarding të OJQ Nevo Koncepti;
 - nënshkruajë Kodin e Mirësjelljes (Code of Conduct).
 - raportojë menjëherë çdo shqetësim ose dyshim lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, shfrytëzimin, abuzimin ose ngacmimin, sipas procedurave të organizatës.
- OJQ Nevo Koncepti rezervon të drejtën të mos angazhojë ose të ndërpresë angazhimin e çdo kandidati/eje që nuk pajtohet ose nuk respekton standardet dhe politikat e safeguarding të organizatës.

5. AFATI KOHOR

Numri i rezultatit	Tituli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgatitja e metodologjisë dhe instrumenteve të vlerësimit	Hartimi dhe adaptimi i metodologjisë së Kartelës Komunitare të Vlerësimit, përfshirë planin e punës, instrumentet e mbledhjes së të dhënave dhe materialet mbështetëse.	5	Korrik 2026
2	Koordinimi dhe organizimi i procesit të vlerësimit	Koordinimi me institucionet shëndetësore dhe akterët relevantë, planifikimi i takimeve dhe organizimi i aktiviteteve në terren.	5	Korrik 2026
3	Zbatimi i procesit të Kartelës Komunitare të Vlerësimit	Facilitimi i takimeve, sesioneve konsultative dhe mbledhja e të dhënave nga fëmijët, prindërit, kujdestarët dhe ofruesit e shërbimeve shëndetësore.	10	Korrik – Gusht 2026
	Analiza e të dhënave dhe hartimi i planit të veprimit	Analizimi i gjetjeve, identifikimi i prioriteteve dhe hartimi i rekomandimeve dhe planit të përbashkët të veprimit.	5	Gusht 2026
	Dorëzimi i raportit përfundimtar	Përgatitja dhe dorëzimi i raportit përfundimtar që përmbledh metodologjinë, gjetjet, rekomandimet dhe planin e veprimit.	3	Shtator 2026
	Gjithsej:		5	

6. REZULTATET E PRITSHME

Në përfundim të angazhimit, priten të arrihen rezultatet e mëposhtme:

- Është zhvilluar dhe zbatuar metodologjia e Kartelës Komunitare të Vlerësimit në institucionet shëndetësore të përzgjedhura.
- Janë mbledhur dhe analizuar të dhëna mbi qasshmërinë, cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore për fëmijë, duke reflektuar perspektivat e fëmijëve, prindërve, kujdestarëve dhe ofruesve të shërbimeve shëndetësore.
- Është realizuar vlerësimi i funksionimit të mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve brenda sektorit shëndetësor, në përputhje me legjislacionin dhe politikat kombëtare përkatëse.

- Janë identifikuar sfidat, nevojat dhe mundësitë për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijë dhe mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve.
- Është forcuar bashkëpunimi dhe dialogu ndërmjet komunitetit, institucioneve shëndetësore dhe akterëve të tjerë relevantë për adresimin e çështjeve prioritare.
- Është hartuar një plan i përbashkët veprimi me rekomandime konkrete dhe masa të realizueshme për përmirësimin e qasshmërisë, cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore për fëmijë.
- Është përgatitur dhe dorëzuar raporti përfundimtar, i cili përfshin metodologjinë e përdorur, gjetjet kryesore, rekomandimet dhe planin e veprimit.
- Janë krijuar baza të qëndrueshme për forcimin e llogaridhënies sociale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve shëndetësore dhe mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve.

7. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV.
- b) Metodologjia e propozuar e mbajtjes së punëtorisë.
- c) Dy (2) referencë.
- d) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.
- e) Oferten Financiare Bruto

Aplikimi duhet të dërgohet jo më larg se data 21.08.2026 në prokurimi@nevokoncepti.org